



Pranimar / Doretuar Primiten / Prodato Received / Delivered		15-02-2024	4	viti god Year
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSH/C	911/2024		117	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1538/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1538/2023 të datës 19.12.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.39737 të datës 30.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.02.2024, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1538/2023 e datës 19.12.2023 të parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli Nr.39737 i datës 30.11.2023 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Kamenicës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Kamenicës, sipas shkresave të lëndës në pozitën e punës „Përgjegjës për punë juridike” në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, më datë 02.11.2023 Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore, ndërsa Komisioni Disiplinor në Komunën e Kamenicës më datë 30.11.2023 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.39737, përmes se cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar ankueses masën disiplinore „Ndalim prej 20% të pagës për periudhën prej dy (2) muaj”.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.39737 të datës 30.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kamenicës, brenda afatit ligjor komfor nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, më datë 19.12.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3910/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Vendimi i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkelje të dispozitave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.12.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Kamenicës. Ndërsa Këshilli më datë 29.12.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër VK/2024 dhe numër të protokollit 648/2024 të datës 01.02.2024 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1538/2023 të parashtruar nga ankuesi dhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 7553/2023 të parashtruar më datë 19.12.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për Kosovën; Vendimin për Pushim Mjekësor të datës 16.11.2023; Vendimin me numër Nr.01/date 24/11/2023 të lëshuar nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil; Dëshmi e datës 01.11.2023; E-mail i datës 24.10.2023; Komunikimet elektronike të datës 23.10.2023; Shkresë nga Komuna e Kamenicës; Shkresë me numër Nr.21/2022 të datës 20.10.2022; Vazhdimet e komunikimeve elektronike të datës 23.10.2023; Fatura e tatimit në pronë me numër të faturës 3355083202 të datës 22.08.2022; Formularin për kërkesë apo ankesë Nr.35354 të datës 20.10.2023; Vërtetimin me numër 4076 të datës 17.10.2023; Kërkesa me numër Nr.05.29989 e datës; Vendimin me numër reference Nr.34686 të datës 16.10.2023; Kërkesën për shlyerjen e borxhit për mos ushtrim të veprimtarisë me numër Nr.05/29989 të datës 01.09.2023; Komunikimet elektronike të datës 16.10.2023, 10.10.2023, 12.10.2023; Vendimin me numër Nr.20856 të datës 05.07.2022; Komunikimet elektronike të datës 18.07.2022, 27.07.2022, 28.07.2022; Kërkesën për përdorimin e automjeteve zyrtare të datës 16.06.2023; Kërkesën për përdorimin e automjeteve zyrtare të datës 13.06.2023; Kërkesën për përdorimin e automjeteve zyrtare të datës 05.06.2023; Kërkesën për përdorimin e automjeteve zyrtare të datës 28.04.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 24.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 31.01.2023; Rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha Janar 2023; E-mail i datës 17.03.2023; Formularin për kërkesë apo ankesë 25.01.2023; Ankesën ndaj faturës së tatimit në prone me numër Nr.2736 të datës 25.01.2023; Kopjen e letërnjoftimit me numër Nr.533614 të datës 07.06.2021; Fatura e tatimit në pronë me numër 3354522351 të datës 25.01.2023; Certifikatën e vlerës së vlerësuar me numër 2109805 e datës 31.10.2022; Letrën e rekomandimit për aprovim të datës 24.02.2023; Procesverbalin për verifikimin e ankesave të datës 24.02.2023; Vendimin me numër Nr.45/2018 të datës 18.06.2018; Vendimin me numër

Nr.10/ZTP të datës 18.04.2023; Vendimin me numër Nr.03/ZTP të datës 18.04.2023; Vendimin me numër Nr.245 të datës 07.09.2023; Vendimin me numër Nr.26787 të datës 10.08.2023; Vendimin me numër Nr.177 të datës 27.06.2022; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit Nr.28118 të datës 03.09.2015; Komunikimet elektronike të datës 03.11.2023, 26.11.2023, 12.10.2023, 25.09.2023, 16.03.2023; Propozimin-Vendimin për Bartjen e Mjeteve nga të Hyrat Vetanake për vitin 2023; E-mailin e datës 16.10.2023, 04.10.2023, Përgjigjen në prapsim të datës 04.10.2023; Komunikimet elektronike të datës 10.10.2023, 02.06.2023, 06.06.2023, Dëshminë nga Komuna e Kamenicës; Komunikimet elektronike të datës 03.11.2023, 26.10.2023, 23.10.2023; Njoftimin e datës 23.10.2023; E-mailin e datës 12.10.2023; E-mailin e datës 23.10.2023; Dëshminë e datës 30.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.12.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 29.12.2023; Dëshminë e datës 29.12.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 31.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 24.01.2022; Komunikimet elektronike të datës 27.12.2023; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit me numër Nr.28118 i datës 03.09.2015; Aktvendimin për caktimin-transferimin në punë dhe detyrat tjera të punës me Nr.24034 të datës 03.08.2015; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore për shërbyesin civil të datë 01.11.2023; Komunikimet elektronike të datës 24.11.2023, 20.11.2023 dhe 23.10.2023; Kërkesën për shlyerjen e borxhit për mos ushtrim të veprimtarisë Nr.29989 të datës 01.09.2023; E-mailin e datës 28.07.2022; Njoftimin lidhur me fillimin e procedurës disiplinore Nr.37470 të datës 07.11.2023; Evidencën e lëndëve; Procesverbalin e mbledhjes së seancës dëgjimore të datës 01.11.2023 dhe 17.11.2023; Procesverbalin e mbledhjes së seancës dëgjimore të datës 02.11.2023 dhe 22.11.2023; Procesverbalin e mbledhjes së seancës dëgjimore të datës 24.11.2023; Dëshminë mbi pranimin e vendimit Nr.39739 të datës 30.11.2023; Komunikimet elektronike të datës 22.11.2023, 15.11.2023, 13.11.2023, 08.11.2023; Rregulloren për taksat dhe gjobat komunale; Konfirmimin e Ligshmërisë së Rregullores të datës Nr.43-69 të datës 15.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e *pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me numër Nr.28118 të datës 03.09.2015 ka konstatuar se ankuesi është i sistemuar në pozitën e punës „Përgjegjës për Punë Juridike“ në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa pranë Komunës së Kamenicës. Ndërsa ndaj të njëjtit Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, gjegjësisht Udhëheqësja e tij e drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me arsyet e dhëna për mosrespektimin e afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës si dhe braktisje e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ditë ose më shumë ditë punë.

Tutje Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor në Komunën e Kamenicës, më datë 30.11.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr.39737 përmes së cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore „*Ndalim prej 20% të pagës për periudhën prej dy (2) muaj*“, me arsyetimin se „*I njëjti në periudha të caktuara ka filluar neglizhimin e Drejtores dhe dliënien e detyrave të punës për ti kryer, nga rrjedhë se e njëjta përmes*

e-maileve zyrtare ka kërkuar të shqyrtohen kërkesat, të cilat ishin të parashtruar nga palët dhe që në fakt ky ankuesi i ka neglizhuar kërkesat dhe nuk i ka përmbushur detyrat e punës në kuadër të pozitës që mbanë si përgjegjës për punët juridike në Drejtorinë e Financave, përveç kësaj në vazhdimësi e lëshon vendimin e punës gjatë orarit të punës pa e njoftuar askënd duke shkaktuar pritje të qytetarëve që kanë nevojë të kryejnë shërbime në sektorin përkatës. Më e rënda nga të gjitha është se nga data 24.10.2023 deri më datën 01.11.2023 nuk është lajmëruar në vendin e punës duke mos dhënë asnjë informatë, nëse është i sëmurë dhe ti ketë sjellë shenjat e sëmundjes nga njëjku. Me këto veprime për mos vijim në punë ka shkaktuar shkelje të rëndë braktisje e punës për tri ditë apo më shumë”

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.39737 të datës 30.11.2023 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Kamenicës ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7553/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor me nxjerrjen e vendimit të lartpërmendur ka bërë shkelje procedurale dhe materiale si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Andaj kërkon që ti aprovohet ankesa si dhe të anulohet Vendimi me numër Nr.39737 i datës 30.11.2023 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Kamenicës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me Vendimin me numër protokoli Nr.39737 të datës 30.11.2023 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Kamenicës përmes së cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndalim prej 20% të pagës për periudhën prej dy(2) muaj”, me arsyetimin se i njëjti është përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore konkretisht „Mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës” të përcaktuar me nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit dhe ka analizuar dëshmitë e ofruara nga palët konkretisht Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore si dhe rrjedhshmërisë së shqyrtimit të lëndës disiplinore ndaj ankuses, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se referuar e-majlave zyrtarë të datës 21.10.2022 dhe 24.10.2022 të Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa drejtuar ankuesit ku ka kërkuar nga i njëjti dy raste si në vijmë: 1. „Ju lutem ma dërgoni raportin e punës për javën e kaluar” si dhe 2. „Ju lutem brenda ditës të ma dërgoni raportin javor prej të hënës deri më sot”, mirëpo i njëjti nuk i ka dorëzuar raportet dhe as nuk është përgjigjur në e-mailin e Drejtoreshës, po ashtu në e-mailin e datës 27.07.2022 të Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa drejtuar ankuesit është cekur se „ Hasan biseduam që sot me qenë në zyre dhe me i krye disa punë dhe jo me dal në terren, unë po e shoh që ora 09:25 keni dal dhe ende nuk jeni kthyer. Ju lutem që të keni mirëkuptim herave tjera dhe të respektoni fjalën time për më shumë do të marrë masa ndaj teje”, ndërsa i njëjti nuk e ka zbatuar urdhrin e drejtoreshës dhe ka dal në teren, ndërsa në e-mailin e datës 28.07.2022 të Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa drejtuar ankuesit sheksohet „Punën dje që ua kërkoja rreth hartimit të draft rregullores për ndryshim ne taksa dhe gjoba nuk e zbatuat dhe pa lejen time dolët në terren, ju lutem njoftoni me shkrim se cilat biznese i keni vizituar ju dje prej orës 09:25 deri në ora 14:00”, ndërsa i njëjti (nuk i dorëzon raportit rreth vizitës se bizneseve si për çfarë arsye ka dal në terren si dhe cilat punë i ka kryer, por i shkruan se shënimet i mbanë Zyrtari i inkasimit dhe se rregullorja nuk mundet te behet ne afat rekord por nevojitet kohe ne mënyrë qe te behët ne harmonizim me ligjet ne fuqi, në po të njëjtën datë rreth orës 13:39 Drejtoresha për Buxhet dhe Financa ka dërguar edhe një e-mail me titullin Mosrespektim „Jam e informuar që rregullorja dëshiron kohë për përgatitje të paktën me ja filluar me punuar në atë drejtim, ju se morët fjalën time për bazë dhe plus dolët në terren pa lejen time dhe çka është më keq kur u kthyet kinse prej terrenit pasi e lexuat e-mailin erdhët në zyrën time dhe më the: Me shkru diqka, si dush shkruama një

vërejtje, u largove dhe e përplase derën. Të jesh i informuar se tash e tutje puna jote mbetet vetëm në zyre ashtu siç e keni me përshkrimet e juaja të punës dhe çdo mungesë në zyre dua arsyetim me shkrim nga ana juaj. Gjithashtu unë pres me shkrim deri në ora 16:00 listën e bizneseve që ju vizituar dhe", si dhe në e-mailin e datës 23.10.2023 të Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa drejtuar ankuesit Hasan Keqmezi „ Pasi që nuk kemi zyrtar ligjor në ZTP, ju duhet të shqyrtoni ankesat dhe kërkesat në ZTP pasi që është sektor i drejtorisë për Financa dhe Buxhet andaj nga ju pres që të shqyrtohet çdo kërkesë që ka të bëjë me DBF pasi që ju jeni përgjegjës për punë juridike në DBF“. Andaj duke marrë parasysh faktet e lartcekura Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa bazuar në nenin 59 paragrafi 2 të Ligjit me numër Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku theksohet se „2.Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil“, date 02.11.2023 ka parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor kundër ankuesit dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në këtë rast është mbikëqyrësja e tij e drejtpërdrejtë, kështu që e njëjta sipas dispozitave të lartcekura ka të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor në pajtim me nenin 59 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë ku është përcaktuar se: “4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunëses/it civil, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit nga Drejtoresha për Buxhet dhe Financa është në pajtim me dispozitat e lartcekura.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar secilën provë veç e veç e gjithashtu duke u bazuar në komunikimet elektronike të Drejtoreshës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Kamenicës Kolegji i Këshillit i ‘u referua Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenin 56 paragrafi 4 ku përcaktohet qartë se „ 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajtlitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja efi dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacnimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjisllacionin në fuqi“, dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se, „ 1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të

bëhet me veprim apo mosveprim", dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mbajnë përgjegjësi disiplinore në rastet kur konstatohet se të njëjtit me veprim ose mosveprim kanë shkelur dispozitat e ligjit material dhe legjislacionit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbajnë, mirëpo vetëm nëse për një çështje të tillë plotësohen parakushtet ligjore për zhvillimin e procedurës disiplinore në pajtueshmëri me Rregulloren Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sikurse personat zyrtar po ashtu janë përgjegjës nëse në cilësi të autoritetit zyrtar përkitazi me mandatin ligjor që buron nga akti i themelimit të marrëdhënies së punës të ndërlidhur me përshkrimin e detyrave të punës në kuptim edhe të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1 dhe 2, dhe nenin 8 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nëse të njëjtit kryejnë veprime që cenojnë apo shkelin parimin e barazisë dhe mos diskriminimit, parimin e objektivitetit dhe paanësisë, parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme të ndërlidhura me përgjegjësinë për procedurën dhe vendimmarrjen në kuadër të autoritet zyrtar që ushtron sipas mandatit që ia ka njohur ligji material. Andaj duke marrë parasysh faktin se ankuesi edhe në deklaratat e dhëna në seancën dëgjimore para Komisionit Disiplinor në Komunën e Kamenicës, nuk ka arritur që ti argumentoj me prova dhe fakte shkeljet e supozuara, Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara sepse ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në pajtim me nenin 59 paragrafi 2 të Ligjit me numër Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë ku theksohet se „2.Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil“ ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.39737 të datës 30.11.2023, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, dhe i njëjti në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 55 dhe 56 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore, po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje me gjendjen faktike sepse Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës ka konstatuar që ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës duke mos respektuar afatet e caktuara për përmbushjen e detyrave të punës respektivisht në këtë rast Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.39737 të datës 30.11.2023, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht me nenin 55 paragrafi 1, nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3, nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, nenin 58 paragrafi 2, nenin 61 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitat të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, e cila ka qene e aplikueshme në kohën kur i është iniciuar procedura disiplinore, po ashtu Kolegji konstaton se këtë rast Komisionit Disiplinor i Komunës së Kamenicës vendimin e ka nxjerr duke u bazuar në provat vendimtare që kanë të bëjnë më rastin konkret, dhe të njëjtin e ka arsyetuar në përputhje të plotë me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet të ankuesit ndaj këtij vendimi janë pretendimet të pabazuara dhe të pa argumentuar me prova konkrete.

Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1538/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.